



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 27.4.2016 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivkoviç, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviç, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha,

Pjesëmarrës të tjerë : përfaqësues nga OSBE-ja Senad Karaahmetoviç; përfaqësuese nga KDI-a Mërgime Kajtaç; konsultant i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz- Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivkoviç**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithëshëm dhe Zyrën Kombëtare të Republikës së Kosovës me amendamente të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-081 për Enërgjinë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-083 për Falimentimin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithëshëm dhe Zyrën Kombëtare të Republikës së Kosovës me amendamente të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithëshëm dhe Zyrën Kombëtare të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit, që të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente të Komisionit funksional, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim.

Pas diskutimeve në projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithëshëm dhe Zyrën Kombëtare të Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor.

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe raportin me amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-081 për Enërgjinë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infstrukturë, Tregti dhe Industri.

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-081 për Enërgjinë me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe raportit me amendament të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-081 për Enërgjinë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-083 për Falimentimin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infstrukturë, Tregti dhe Industri.

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-083 për Falimentimin me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe raportit me amendament të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-083 për Falimentimin dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infstrukturë, Tregti dhe Industri.

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe raportit me amendament të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme

Muferra Sinik, diskutoi lidhur me çështjen e qytetarëve të cilët kanë shtetësinë e një vendi ndërsa jetojnë në një vend tjetër, dhe me këtë rast humbin të drejtën e shtetësisë.

Lidhur me këtë problematikë, që Komisioni të ftojë në takim, ministrin e Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni me qëllim të ofrojë sqarime lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e shtetësisë.

Danush Ademi – informoi komisionin, se javën e kaluar ka vizituar rektorin e ri, ku është shtjelluar tema lidhur me mos shpalljen e konkursit të tretë për regjistrimin e studentëve të komunitetit jo shumicë, në vitin akademik 2015. Gjatë bisedimeve, Rektori ka premtuar se e njehta nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Edhe përkundër premtimeve, ishte i mendimit që një grup i anëtarëve të komisionit të vizitojë Rektorin me qëllim të kërkesave tona lidhur me procedurat e shpalljes së konkursit të rregullt për kandidatët e komuniteteve, për vitin akademik 2016-2017.

Veton Berisha, propozimi i tij ishte që në takim, të ftohet ministri i FSK-së dhe Drejtori i policisë, me temën: Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në shërbimin policor dhe gradimi i tyre.

Në bazë të diskutimeve, Komisioni u pajtua njëzëri, dhe nxorën këtë:

Përfundim

- I. Obligohet administrata për mbështetje të komisionit, që në javën e parë të muajit maj, të procedojë ftesën ministrit të Ministrisë për Punë të Brendshme dhe në javën e katërt Ministrit të FSK-së së bashku me Drejtorin e policisë.*
- II. Një grup i anëtarëve të komisioni, të vizitojë Rektoratin e Univerzitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, me qëllim të marrjes së informatave lidhur me procedurat e shpalljes së konkursit të rregullt për kandidatët e komunitetit pakicë, në vitin akademik 2016-2017.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković